



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 3431 prot

Ballsh më 2207 / 2025

VENDIM

Nr. 07 datë 22 / 07 / 2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.12 datë 24.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 22/07/ 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 29/07/ 2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

2 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Alxhmi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 3931 / prot.

Ballsh më 22.07.2025

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e **Martë, datë 29 .07.2025, ora 10:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 26.06.2025.
3. **Projektvendim Nr.26:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.27:** Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.
5. **Projektvendim Nr.29:** Për përdorimin e fondeve të kushtëzuara të mbrojtjes civile për vitin 2025.
6. **Projektvendim Nr. 30:** Për dhënien në përdorim për një afat deri në 10-vjet, të sipërfaqes pyjore prej 1.2 ha, ngastra me nr.35, ekonomia kullimore Ballsh-Fratar, për qëllime Pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike.
7. Diskutime të tjera në lidhje me kërkesat e qytetarëve.

Mbledhja e komisioneve: për pikat 3,4,5 dhe 6 të rendit të ditës, Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni Juridik.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

